



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM VLORË**

Nr. 4141 Prot.

Vlorë më, 03.03.2026.

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR SPECIALIST-ARKIVIST

Në zbatim të ligjit Nr 97 dt.06.10.2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 42,70,74,76,80,82) Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë specialist-arkivist.

Kushtet e përgjithshme:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, si dhe të mos jetë nën hetim;
- dh) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas afateve të parashikuara në ligj;
- e) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare dega Juridik;

Kushtet e posaçme:

- a) Të ketë aftësi për të krijuar plane pune efektive në përpunimin e materialeve arkivore.
- b) Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive.
- c) Të ruajë konfidencialitetin e materialeve arkivore.
- d) Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.
- e) Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me trajtimin e fondeve arkivore.
- f) Të ketë njohuri të mira kompjuterike .

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

- a) Njohja e proceseve të përpunimit e ruajtjes së fondeve arkivore.
- b) Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

Përshkrimi i punës:

- a) Punonjësi pranon, ruan e përpunon aktet proceduriale e administrative, në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

b)

Funksionet kryesore:

- a) Merr në dorëzim fashikuj, akte e dokumentacion për arkivim.
- b) Përpunon materialet arkivore, duke inventarizuar sipas procedurave standart të gjitha këto akte, si në formë elektronike, ashtu edhe manuale.
- c) Kujdeset për mirëmbajtjen e indekseve dhe regjistrave të arkivës.
- d) Përgatit mbi kërkesën e të interesuarve, aktet të cilat do të vendosen këtyre personave në dispozicion pas miratimit të kërkesës nga drejtuesi i Prokurorisë.
- e) Është pjesë e Komisionit të Ekspertizës për përpunimin e materialeve arkivore.
- f) Merr pjesë në trajnimet ku trajtohen çështje që lidhen me arkivat.
- g) Bashkërendon me Arkivin Shtetëror të Sistemit të Drejtësisë për problematika të vërejtura në veprimtarinë e përditshme.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, dhe master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje të librezës së punës.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deri në datën 18.03.2026 ora 08:00-16:00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kancelari i Prokurorisë, e cili pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nga Komisioni i Pranimi bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat, si dhe rezultatit të intervistës me secilin prej tyre. Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambientet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në datën që do të vendoset nga komisioni i pranimi, të cilët do të njoftohen me telefon ose e-mail nga Kryesekretaria.

Për çdo sqarim mund të paraqiteni në ambjentet e kësaj Prokurorie çdo ditë nga dita e hënë deri ditën e preme nga ora 08.00 - 16.00, (ku do të gjeni njoftimin të afishuar në hyrje të Prokurorisë), ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al/Vlorë, ku do të publikohet kjo shpallje.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

